



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 692 Akti

Nr. 750 Vendimi  
Tiranë, më 28.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 2 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Relatore</b>
<b>Olsi Komici</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 26.3.2024, ora 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arian Muçaj**, aktualisht ushtron funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Arian Muçaj i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë<sup>1</sup>, gjatë periudhës së rivlerësimit. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2.
2. Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, të trupit gjykues, është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, është vendosur fillimi i hetimit administrativ kryesisht dhe është caktuar kryesues i trupit gjykues komisionerja Firdes Shuli.
3. Më tej, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP). Subjekti është kontaktuar nëpërmjet adresës elektronike, deklaruar për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua pyetëtori standard i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera gjatë hetimit administrativ.
5. Trupi gjykues, i mbledhur në datën 27.2.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vendosi: (a) përfundimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Arian Muçaj, në përputhje me pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera, thirrjen e dëshmitarit, afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta, si dhe të paraqesë parashtrimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e administruara në dosjen e hetimit duke marrë një kopje të saj dhe brenda afatit të caktuar nga Komisioni paraqiti shpjegime e prova lidhur me rezultatet e hetimit.
7. Më tej, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ftoi subjektin e rivlerësimit Arian Muçaj për t’u paraqitur në seancë dëgjimore në datën 26.3.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë.
8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 26.3.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në këtë seancë.
9. Gjatë kësaj seance subjekti i rivlerësimit parashtrroi qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit. Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

<sup>1</sup> Me Dekretin Nr. 9127, datë 1.6.2015, të Presidentit të Republikës, subjekti i rivlerësimit Arian Muçaj është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Aktualisht ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

10. Trupi gjykues diskutoi lidhur me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit referuar rezultateve të hetimit.

11. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për z. Arian Muçaj, në seancën e datës 26.3.2024, ora 10:00, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

## II. PROCESI I RIVLERËSIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë sipas bindjes së tyre të brendshme çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

13. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse<sup>2</sup>.

14. Bazuar në nenet 45,49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar nga institucionet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore;
- d) raportin e dorëzuar në Komision nga KLP-ja, së bashku me materialin shoqërues dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit shkresor, elektronik dhe gjatë seancës dëgjimore;
- f) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- g) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- h) denoncimet nga publiku.

## III. RRETHANAT E ÇËSHTJES

15. Subjekti i rivlerësimit është martuar në vitin 2001 me znj. Gentiana Muçaj, me detyrë<sup>3</sup> gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila i është nënshtruar gjithashtu procesit të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni, përfunduar me Vendimin nr. 633, datë 9.3.2023 të KPK (i paankimuar).

16. Subjekti rivlerësimit z. Arian Muçaj ka plotësuar Deklaratën Veting për familjen e tij (bashkëshorten dhe dy fëmijët). Nga verifikimet ka rezultuar se deri në datën 7.10.2016 ai ka qenë në përbërje familjare edhe me babain dhe motren e tij, e në vijim ai është ndarë nga gjendja familjare me prindërit, duke kaluar në përbërje familjare vetëm me bashkëshorten dhe dy fëmijët e tyre. Në vijim të shpjegimeve ai deklaroi gjithashtu se de fakto ka jetuar i veçuar nga familja e prindërve në banesën e tij me bashkëshorten dhe 2 fëmijët, qysh prej martesës së tyre, pavarësisht gjendjes sipas certifikatës së tyre familjare.

<sup>2</sup> Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese pika 41.

<sup>3</sup> Emëruar gjyqtare që prej 1 tetor 2001

17. Nga verifikimi i dokumentacionit<sup>4</sup> rezulton se në datën 8.10.2016<sup>5</sup> subjekti rivlerësimi është ndarë nga trangu familjar i origjinës, por kjo situatë nuk e përjashton atë nga përgjegjësia ligjore, për deklarimin e pasurive për personat e lidhur, në Deklaratën *Vetting*, sipas detyrimit ligjor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, deklarim i cili nuk është përmbushur prej subjektit deklarues.

18. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimi nëpërmjet pyetësorëve të deklarorjë lidhur me personat e lidhur që ai ka pasur në certifikatën e gjendjes së tij familjare, bazuar në Udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, për të cilat ai është përgjigjur duke vënë në dispozicion informacionin e kërkuar, i trajtuar dhe vlerësuar më poshtë në këtë vendim.

19. Në lidhje me mosdeklarimin prej tij në Deklaratën *Vetting* sipas kërkesave ligjore e akteve nënligjore në kuadër të këtij procesi, subjekti ka shpjeguar: *“Në vijim të konstatimit nga Komisioni shpjegoj se unë kam qenë në të njëjtin trung familjarë me S. M., E. M. dhe R. M. deri në vitin 2016 ashtu siç kam qenë në kohën kur kam lidhur martesë ligjore. Në datën 30.6.2016, motra ime, znj. R. M., ka lidhur martesë ligjore me shtetasin italian G. M., me të cilin vazhdon të jetojë deri më sot në Itali. Duke e konsideruar të vështirë marrjen e informacionit dhe dokumentacionin përkatës, përkthimin, legalizimin dhe dërgimin në Shqipëri, si edhe vështirësinë që do të kisha në lidhje me verifikimet e pasurisë së kунatit tim që është shtetas italian me legjislacion të ndryshëm nga legjislacioni shqiptar, vendosa të bëj ndarjen familjare nga trangu i familjarëve të mi. Kjo është arsyeja për të cilën kam bërë ndarjen nga familjarët e mi dhe jo për të shmangur nga deklarimi në procesin e rivlerësimi familjarët e mi”*.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimi deklaroi se në kohën që ka plotësuar Deklaratën *Vetting*, ka qenë i ndarë nga familjarët e tij për arsyen e cituar më sipër dhe në arsyetimin ligjor që ka bërë në atë kohë e ka konsideruar si gjendje familjare të familjes atë që ishte në momentin kur ka plotësuar Deklaratën *Vetting*, e cila është plotësuar pasi është shprehur Gjykata Kushtetuese në lidhje me ligjshmërinë e ligjit nr. 84/2016.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

20. Subjekti i deklarimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimi në ILDKPKI së bashku me dokumentacionin provues. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e tij ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**21. Komisioni ka verifikuar pasuritë e deklaruara nga subjekti rivlerësimi në Deklaratën e pasurisë *Vetting*, si më poshtë.**

**22. Apartament me sipërfaqe 108.75 m<sup>2</sup>**, ndodhur në Selitë, përfituar në datën 28.12.2009, në bashkëpronësi tërësore me babain S. M.. Vlera e deklaruar e pasurisë është 79.387 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) euro. Subjekti i ka bashkëlidhur Deklaratës *Vetting* disa dokumente<sup>6</sup>. Burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: (a) vlera

<sup>4</sup> Certifikatë familjare datë 23.1.2023 në lidhje me ndryshimin e gjendjes familjare

<sup>5</sup> Ligji nr. 84/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.9.2016 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

<sup>6</sup> Kontratë Sipërmarrjeje (për ndërtim apartamenti) nr. \*\*\*, datë 28.12.2009, me palë sipërmarrëse shoqëria \*\*\*\*\* sh.p.k. dhe palë porositëse Arian Muçaj dhe S. M., të apartamentit me sipërfaqe totale 108.75 m<sup>2</sup>, në adresën rruga \*\*\*\*\*, Tiranë, me vlerë 79.387 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) euro. Paga në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro është kryer në momentin e nënshkrimit të kontratës. Kësti i dytë i pagesës në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro do të paguhet në datën 25.1.2010 dhe kësti i fundit 4.387 (katër mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) euro do të paguhet në momentin që porositësi do të marrë dokumentin e pronësisë. Vendimi nr. \*\*\*, datë 29.7.2005, nga KRRT-ja, planimetria e katit, planimetria e apartamentit. Deklaratë Noteriale nr. \*\*\*, datë 18.4.2008, me deklaruesit S. M. dhe I. S., në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 66.68 m<sup>2</sup>, të ndodhur në katën e dytë të një pallati 7-katësh afër \*\*\*-it, Tiranë, e cila është shitur në vlerën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro. Nxjerrje llogarie bankare nga BKT-ja, datë 14.10.2016, në emër të shtetasit S. M., derdhje *cash* në vlerën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro, datë 16.4.2008, nga shtetasi I. S., me përshkrimin “Derdhje për S. M.j blerje apartamenti”. Mandatarkëtim nr. \*\*\*, datë 1.2.2001, nga shoqëria \*\*\*\*\* sh.p.k., ku shtetasi S. M. ka arkëtuar shumën 21.000 (njëzet e njëmijë) USD, pagesë për apartamentin 1+1. Mandatarkëtim nr. \*\*\*, datë 22.9.2001, nga shoqëria \*\*\*\*\* sh.p.k., ku

50.000 (pesëdhjetë mijë) euro e përfituar nga shitja e banesës 1+1 me sipërfaqe 66.68 m<sup>2</sup> shtetasit I. S.; (b) kredia në vlerën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, marrë pranë BKT-së në datën 30.1.2010.

**22.1** Nga verifikimi rezulton Kontratë Sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 28.12.2009, lidhur mes shtetasit A. Ç. në cilësinë e sipërmarrësit dhe shtetasve Arian Muçaj e S. M. në cilësinë e porositësve. Çmimi i pasurisë së porositur është përcaktuar të jetë në vlerën 79.387 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) euro (730 euro/m<sup>2</sup>), likuiduar vlera prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro nga shtetasi S. M. në momentin e nënshkrimit të kontratës, konfirmuar sipas mandatit bankar datë 14.12.2009 nga Tirana Bank<sup>7</sup>.

**22.2** BKT-ja ka paraqitur pranë Komisionit informacionin në lidhje me kredinë e akorduar subjektit Arian Muçaj<sup>8</sup>, lëvruar në datën 10.2.2010 në vlerën 3.465.000 (tre milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, transferuar në datën 18.2.2010 në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për shlyerje detyrimi blerje apartamenti.

**22.3** Kësti i fundit në vlerën 4.387 (katër mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) euro rezulton të mos jetë paguar, referuar kontratës së sipërmarrjes dhe shlyerja e tij kushtëzohet nga lidhja e kontratës së shitjes dhe marrja e certifikatës së pronësisë nga blerësit.

**22.4** Nga komunikimi me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës nuk rezultoi që pasuria e mësipërme të jetë e regjistruar në regjistrat kadastralë.

**22.5** ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug informon<sup>9</sup> se Leja e Legalizimit nr. \*\*\*, datë 29.7.2020, ka dalë në emër të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. për të gjithë objektin “Godinë e kombinuar 2, 4, 6 kat + 1 kat nëntokë”.

### **Analiza e burimit të krijimit të pasurisë**

**22.6** Nga dokumentacioni ka rezultuar se burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 108.75 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, ka qenë shitja e pasurisë me sipërfaqe 66.68 m<sup>2</sup>, ndodhur në bllokun “\*\*\*\*”, shtetasit I. S.. Shitja e kësaj pasurie është dokumentuar nëpërmjet Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.4.2008 (para noterit publik M. B.), mes palëve I. S. dhe S. M., ku deklarohet se shtetasi I. S. ka blerë një apartament 1+1, me sipërfaqe 66.68 m<sup>2</sup>, me çmim 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro nga shtetasi S. M., çmim i cili i është likuiduar e plotë shitësit.

**22.7** Të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie në vitin 2008 janë depozituar nga shtetasi I. S. në llogarinë e shtetasit S. M. në BKT, me përshkrimin “Për blerje apartamenti”, depozituar *cash*<sup>10</sup>.

**22.8** Në Deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit deklaron se apartamenti në bllokun “\*\*\*\*” (i shitur në vitin 2008 nga shtetasi S. M.) është blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. pa kontratë<sup>11</sup> e se disponon vetëm dy mandatpagesa të arkëtuara *cash* nga shtetasi S. M. shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.:

- a) mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 1.2.2001, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë 21.000 (njëzet e njëmijë) USD, arkëtuar nga shtetasi S. M. me përshkrimin “Pagesë për apartament 1+1”;
- b) mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 22.9.2001, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë 1.386 (njëmijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) USD, arkëtuar nga shtetasi S. M. me përshkrimin “Likuidim total i apartamentit”.

**22.9** Komisioni kreu analizë financiare mbi burimin e krijimit të pasurisë “Apartament 1+1” në bllokun “\*\*\*\*”, në vitin 2001, nga ku rezultoi se ata kanë pasur mundësi financiare për

shtetasi S. M. ka arkëtuar shumën 1.386 (njëmijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) USD, likuidim total për apartamentin. Dokument nga Tirana Bank datë 14.12.2009, ku citohet se në këtë datë është depozituar shuma 50.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro nga shtetasi S. M., me përshkrimin “Lik. 2 këste apartamenti”. Kontratë kredie bankare nr. \*\*\*, datë 30.1.2010, me BKK-në, kredimarrës Arian Muçaj dhe dorëzanës Gentiana Muçaj, S. M. dhe E. M., në shumën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë. Aneks i çeljes dhe përdorimit të kredisë, qëllimi i kredisë është për blerje apartamenti. Shihni aneksin nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>7</sup> Banka nuk mund të ofrojë materialin e kërkuar, pasi kanë kaluar rreth 15 vite nga kryerja e veprimit në bazë të legjislacionit dhe politikave të arkivimit të bankës.

<sup>8</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021.

<sup>9</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 20.11.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2023.

<sup>10</sup> Referojuni aneksit \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së, verifikuar nëpërmjet *statement* bankar të paraqitur nga BKT-ja në bazë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021.

<sup>11</sup> Referuar rubrikës “Të dhëna konfidenciale” tek Deklarata *Vetting*.

blerjen e kësaj pasurie (analiza mbajti në konsideratë të ardhurat e gjithë familjes dhe shpenzimet e kryera prej tyre).

**22.10** Nga hetimi rezultoi se pasuria me sipërfaqe 66.68 m<sup>2</sup> aktualisht është e regjistruar si “Apartament” në zonën kadastrale nr. \*\*\*, ndodhur në adresën: rruga “\*\*\*\*”, h. \*\*\*, ap. \*\*\* (blloku “\*\*\*\*”). Nga vetë subjekti është paraqitur Certifikata e Regjistrimit të kësaj pasurie me nr. \*\*\*, e lëshuar në datën 25.3.2015, në emër të shtetasit I. H. S..

**22.11** Për sa i përket detyrimit për shlyerjen e tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga shitja, rezulton se për periudhën janar-dhjetor 2022 është deklaruar në seksionin “Fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të deklaruesit” shuma 3.573.931 (tre milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë dhe pagesa e këtij detyrimi është paguar nga shtetasi S. M. nëpërmjet llogarisë bankare në BKT në datën 31.1.2023.

**22.12** Nga informacioni i administruar nga Kadastra për këtë pasuri ka rezultuar se ajo është përfituar nga shtetasi I. S. nëpërmjet Kontratës së Porosisë datë 18.4.2005 dhe, në vijim, Kontratës së Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.3.2015, të lidhura me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. Sipas dokumentacionit, vlera e pronës sipas kontratës së shitjes është 22.600 (njëzet e dy mijë e gjashtëqind) USD, e likuiduar plotësisht me Kontratën e Porosisë së vitit 2005.

**22.13** Nga dokumentacioni i administruar nuk vërtetohet që kjo pasuri të ketë qenë në pronësi të shtetasit S. M. dhe/apo shtetasit Arian Muçaj.

**22.14** Në përfundim, Komisioni ngre dyshime lidhur me pagimin e tatimit sipas legjislacionit në fuqi dhe ligjshmërinë e burimit të shumës 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament të deklaruar në Deklaratën *Vetting*, referuar transaksioneve të kryera për regjistrimin e kësaj prone nga shtetasi I. S..

**22.15** Duket se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaratimet lidhur me origjinën e vërtetë të burimit të të ardhurave për krijimin e pasurisë apartament në bllokun “\*\*\*\*” në vitin 2001. Lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament në rrugën “\*\*\*\*” në vitin 2009 (deklaruar në pronësi të babait nga shitja) Komisioni vlerëson se ato nuk vijnë nga një kontratë shitblerjeje e ngre dyshime për origjinën e tyre.

**22.16** Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, si dhe të japë shpjegime nëse kjo pasuri është krijuar nga vetë subjekti e personat e tjerë të lidhur, me burime të ligjshme, sipas kërkesave të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**22.17** Në vijim të konstatimit nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit me prapësimet dhe shpjegimet e tij deklaroi se: *“Në lidhje me pagimin e tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e këtij apartamenti është vënë në dijeni gjatë periudhës së hetimit administrativ në kuadër të procesit të rivlerësimit të bashkëshortes. Nga ana e babait më është shpjeguar se për shkak se apartamenti nuk ka qenë i regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, e ka pasur të paqartë situatën nëse duhej paguar apo jo tatim fitimi. Duke pasur parasysh dhe praktikën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili me vendime të formës së prerë, të pa ankimuar nga Komisioneri Publik, (vendimi nr. 56, datë 1.8.2018, vendimi nr. 311, datë 20.10.2020 ) ka pranuar pagimin e tatimit mbi të ardhurat edhe për një periudhë shumë të mëvonshme se realizimi i transaksionit, i kam thënë babait që ky tatim mund të paguhej në këtë kohë. Nuk ka qenë asnjëherë në qëllimin të babait tim shmangia e pagimit të këtij tatimi pasi nëse do të ishte paguar në vitin 2008 kur është realizuar transaksioni, ky tatim do të ishte në një masë më të vogël se në vitin 2023, pasi masa e tij ka qenë 10%. Vonesa në pagimin e tatimit mbi të ardhurat ka ardhur për shkak të bllokimit të veprimeve mbi pallatin në të cilin ndodhej ky apartament, bllokim i cili ka vazhduar jo vetëm në vitin 2008, por edhe në vitet e mëpasme. Ky bllokim ka sjellë si pasojë mosrealizimin e kontratës së shitjes dhe mosregjistrimin e kësaj pasurie pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Pra mospasja e certifikatës së pronësisë ka krijuar paqartësi tek babai për pagimin e*

këtij tatimi në kohën e realizimit të transaksionit dhe nuk ka hezitur në asnjë moment që ky tatim të mos paguhej dhe ka qenë gjithmonë i gatshëm për pagimin e tij

Në Deklaratën Vetting administruar nga ILDKPKI-ja, rezulton se për sa i përket burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti është deklaruar se kanë qenë të ardhurat e përfituara nga shpërblimi për kapjen e mallrave kontrabandë. Për sa më sipër, në asnjë moment deklarimet e mia nuk kanë ndryshuar, kanë qenë të njëjta për pronësinë, përdorimin dhe të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e banesës.

Në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament në rrugën “\*\*\*\*” në vitin 2009 (deklaruar në pronësi të babait nga shitja) nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në lidhje me pasurinë e I. S., së cilës Komisioni i referohet, Kontrata e datës 18.4.2005 është kontratë ndërmjet dy palëve I. S. dhe A. B. dhe kjo kontratë është përpiluar nga avokat R. P., i cili është vëllai i bashkëshortes së z. A. B.. Kjo kontratë nuk është kontratë e përpiluar nga noteri dhe për këtë arsye mundet të bëhet në çdo kohë dhe të vendoset data të cilën kanë menduar palët për të nënshkruar pasi nuk kanë asnjë dokument zyrtar tjetër, duke dyshuar se është bërë pas vitit 2008, kur I. S. ka dashur të regjistrojë pronën në emrin e tij në vitin 2015.

Në dokumentacionin e dosjes për apartamentin e z. I. S. që gjendet në ASHK, gjendet edhe një Vërtetim Noterial nr. \*\*\*, datë 18.4.2008, pas Kontratës së datës 18.4.2005, ku para noterit është paraqitur A. B., administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Numri rendor i deklaratës është një numër më pas numrit të repertorit të deklaratës së shitjes së apartamentit ndërmjet S. M. dhe I. S. dhe është e njëjta datë kur është bërë kjo deklaratë, si edhe i referohet pa numër deklaratë, por për sa i përket datës i referohet datës së deklaratës ndërmjet S. M. dhe I. S., duke mos iu referuar kontratës së sipërmarrjes të përpiluar në datën 18.4.2005.

Planimetria e apartamentit 1+1, me sipërfaqe 66.68 m<sup>2</sup>, lëshuar në emër të S. M. është e njëjtë me planimetrinë që i bashkëngjitet Kontratës së Premtim Shitjes datë 18.4.2005, duke u fshirë emri S. M. në këtë planimetri. Edhe me një shikim të lirë të shkrimit në planimetrinë në emër të S. M. rezulton i njëjti shkrim me mandatpagesat e lëshuara në emër të S. M..

Banesa e mësipërme është përdorur nga unë dhe familja ime prej vitit 2001 deri në vitin 2008. Nuk ekziston asnjë lloj mundësie që në vitin 2005 për këtë banesë të lidhej kontratë sipërmarrjeje ndërmjet I. S. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., pasi deri në prill të vitit 2008 kjo banesë ka qenë në pronësi të babait tim. Kontrata për furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike për përdoruesit njëfazor nr. \*\*\*, e lidhur nga S. M., datë 3.9.2001, me adresë “\*\*\*\*”(blloku “\*\*\*\*”) që është pranë \*\*\*-it. Kjo është pikërisht edhe koha kur ka përfunduar pallati ku gjendet banesa 1+1 dhe të gjithë banorët kanë filluar të banojnë në këtë pallat pothuajse në të njëjtën kohë. Pra, prej fillimit, babai im ka qenë pronar dhe unë me familjen time përdorues në këtë banesë. Fatura e muajit mars 2008, në emër të S. M., provon se apartamenti ka qenë përdorur nga ana ime dhe e familjes sime të paktën deri në këtë muaj të vitit 2008. Pas dy ose tre muajsh pagesat janë bërë nga shtetasi I. S..

Në lidhje me mungesën e kontratës së blerjes së pasurisë “apartament 1+1” sqaron se: “Urdhurat e ministrit të Rendit Publik për shpërblimin e punonjësve, të cilët kanë qenë të angazhuar në kapjen e mallrave kontrabandë kanë qenë “Sekret”, për të mos identifikuar përfituesit e shpërblimeve nga shitja e mallrave të konfiskuara. Nga unë iu kërkua babait tim që të mos lidhej kontratë shitjeje ose sipërmarrjeje me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për arsye sigurie të jetës sime dhe familjarëve të mi”.

**22.18** Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të depozituar, konstatoi se nga hetimi identifikohen fakte që dëshmojnë për veprime të ndërsjella ndërmjet palëve. Po ashtu, trupi gjykues vlerëson se rrethanat e faktit se vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar detyrën e prokurorit asaj kohe e se koha është e

largët e, për pasojë, veprimet nuk mund të kenë pasur ndonjë qëllim për ndonjë nga rrethanat e cilësuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 si fshehje, deklaram i rremë apo mungesë burimesh financiare, çmton se ato duhen vlerësuar me proporcionalitet në funksion të qëllimit e misionit të ligjit nr. 84/2016.

**22.19** Në përfundim, trupi gjykues çmton se tërësia e veprimeve lidhur me historikun e krijimit të pasurisë, pjesë e Deklaratës *Vetting* (pasuria e krijuar në vitin 2009), e cila lidhet për shkak të burimit të saj me pasurinë e krijuar në vitin 2001 dhe vlerësimi i rrethanave në harmoni me deklaramet e subjektit dhe situatat reale të pronësisë në vendin tonë ndër vite, duken të besueshme e nuk e ndërlihdhin subjektin e rivlerësimit me ndonjë veprim të kryer me dashje apo qëllim për të mos pasqyruar realisht situatat e ndodhura. Trupi gjykues krijoi bindjen se deklaramet e subjektit të rivlerësimit janë të vërteta e se situatat e krijuara nuk janë relevante për një qëndrim penalizues të tij, në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar, duke e vlerësuar këtë pasuri si pa problematika.

**23. Automjet tip “Daimler Benz A Class”, blerë në datën 5.7.2012**, në shumën 1.000 (njëmijë) euro. Bashkëpronësi në tërësi me znj. Gentiana Muçaj. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaramet disa dokumente<sup>12</sup>.

**23.1.** Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaramet para fillimit të detyrës në vitin 2015, me përshkrimin “Automjet tip “Daimler Benz”, modeli A Class, viti i prodhimit 2002, blerë në vitin 2011 në shumën 1.000 (njëmijë) euro plus TVSH në doganë dhe taksat e regjistrimit të automjetit. Burimi i përfitimit: kursime.

**23.2.** Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në, kjo e fundit informon<sup>13</sup> se z. Arian S. Muçaj ka të regjistruar automjetin me targë \*\*\*. Nga dokumentacioni i administruar nga kjo drejtori konfirmohet blerja e këtij mjete në vlerën 1.000 (njëmijë) euro, me Kontratë Shitjeje datë 5.7.2012, me palë shitëse B. K. dhe palë blerëse Arian Muçaj.

**23.3.** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2012, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

**23.4.** Komisioni nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

**24. Llogari në Intesa Sanpaolo Bank**, çelur në datën 27.7.2000, bono thesari në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, nga shpërblimet e punësimit ndër vite. Gjendja në datën e deklaramit 27.1.2017 është 58.734,53 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër e pesëdhjetë e tre të qindtat) lekë.

**24.1.** Intesa Sanpaolo Bank<sup>14</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit Arian Muçaj ka llogari bankare të çelur pranë saj me balancë 8.750,93 (tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntëdhjetë e tre të qindtat) lekë në datën e deklaramit 27.1.2017. Kjo llogari është çelur nga subjekti i rivlerësimit në datën 27.7.2000 për investim në depozitë bankare, në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Në këtë llogari janë kryer vetëm kreditimi i interesave bankarë dhe tërheqje në periudha të ndryshme të shumës. Diferenca që rezultoi në deklaramin e gjendjes së kësaj llogarie nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën *Vetting* është pasi ka deklaruar gjendjen në datën 30.9.2016, ndërkohë nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie rezultoi se subjekti i rivlerësimit në datën 22.11.2016 ka kryer tërheqje në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

<sup>12</sup> Kontratë Shitjeje datë 5.7.2012, me palë shitëse B. K. dhe palë blerëse Arian Muçaj të mjetit “Mercedes-Benz”, në vlerën 1.000 euro. Mandatpagesë datë 5.7.2012, në vlerën 1.000 euro. Leje qarkullimi i automjetit të vendit të origjinës, Gjermani. Deklaratë Doganore datë 4.9.2012. Urdhër çlirim, Leje Qarkullimi, në emër të z. Arian Muçaj të mjetit me targë \*\*\*. Certifikatë e kontrollit fizik të mjetit, Certifikatë e Pronësisë së mjetit rrugor, me targë \*\*\*, datë 7.9.2012, në emër të z. Arian Muçaj. Mandatarkëtimi nr. \*\*\* për doganën Tiranë, në shumën 38.400 lekë, për zhdoganim. Shihni aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>13</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2021.

<sup>14</sup> Shihni aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.



**24.2.** Kjo diferencë nuk rezulton problematike në procesin e rivlerësimit ndaj subjektit pasi analizimi i tyre është kryer për çdo vit dhe janë përfshirë në analizën financiare të detajuar, po ashtu deklarimi i tij përputhet me të dhënat e fundvitit kalendarik 2016.

**25. Llogari në lekë, në Raiffeisen Bank, gjendja 106.417,79 (njëqind e gjashtë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë e shtatëdhjetë e nëntë të qindtat) lekë, në emër të subjektit Arian Muçaj. Llogari në euro në Raiffeisen Bank – gjendja 0 (zero) euro, në emër të subjektit Arian Muçaj.**

**25.1.** Raiffeisen Bank<sup>15</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit Arian Muçaj ka llogari bankare të çelur pranë kësaj banke, aktive në periudhën 2005 – 2010, në të cilën i është kredituar paga. Gjendja në këtë llogari në datën 30.12.2016 është 113.343,08 (njëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e dyzet e tre e tetë të qindtat) lekë.

**25.2.** Raiffeisen Bank<sup>16</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit Arian Muçaj ka dy llogari bankare të çelura pranë kësaj banke, aktive në periudhën 2007 – 2008, në të cilën i janë kredituar të ardhura honorare. Gjendja në këto llogari në datën 30.12.2016 është 0 (zero) euro dhe 1,58 (një e pesëdhjetë e tetë) euro.

**25.3.** Komisioni nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këto pasuri dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave.

**26. Llogari në lekë, në Credins Bank, gjendja 25.448,01 (njëzet e pesë mijë e katërqind e dyzet e tetë e një të qindtat) lekë, në emër të subjektit Arian Muçaj.**

**26.1.** Credins Bank<sup>17</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit Arian Muçaj ka llogari bankare të çelur pranë kësaj banke, aktive në periudhën 2012 – 2016, në të cilën i kreditohet paga. Gjendja në këtë llogari në datën 30.12.2016 është 25.448,01 (njëzet e pesë mijë e katërqind e dyzet e tetë e një të qindtat) lekë.

**26.2.** Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit në Deklaratën *Vetting* me informacionin e përcjellë nga Credins Bank. Nuk janë konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj.

**27. Llogari në euro, në BKT, në emër të subjektit të rivlerësimit Arian Muçaj. Llogari kredie në BKT, gjendja 88.936,78 (tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë e shtatëdhjetë e tetë të qindtat) lekë në emër të subjektit të rivlerësimit Arian Muçaj.**

**27.1.** BKT-ja<sup>18</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit Arian Muçaj ka llogari në këtë bankë, aktive për periudhën 2012 – 2016, në të cilën i janë kredituar honorare. Gjendja në këtë llogari në datën e deklarimit është në shumën 284,25 (dyqind e tetëdhjetë e katër e njëzet e pesë të qindtat) euro.

**27.2.** BKT-ja<sup>19</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit Arian Muçaj ka llogari në këtë bankë, aktive në periudhën 2010 – 2016, në të cilën kryen pagesat e kësteve të kredisë kryesisht nëpërmjet transferimit të shumave nga llogaria e pagës së bashkëshortes. Gjendja në këtë llogari në datën e deklarimit është 88.936,78 (tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë e shtatëdhjetë e tetë të qindtat) lekë.

**27.3.** Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat dhe shpenzimet e kryera sipas këtyre llogarive e në përfundim nuk kanë rezultuar problematika në lidhje me këto pasuri.

**28. Kursime *cash*, shuma 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë**

<sup>15</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021, dosja e hetimit.

<sup>16</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021, dosja e hetimit.

<sup>17</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2021, dosja e hetimit.

<sup>18</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021, dosja e hetimit.

<sup>19</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021, dosja e hetimit.

**28.1.** Në deklaratën përpara fillimit të detyrës nuk deklarohen kursime, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 deklarohet “Kursime nga pagat e deklaruesit dhe bashkëshortes jashtë sistemit bankar” në vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

**28.2.** Në deklaratën periodike të vitit 2016 nuk ka deklaruar shtesa apo pakësime, për pasojë kjo shumë është mbartur edhe në Deklaratën *Vetting*.

**28.3.** Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi në krijimin e kursimeve cash, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare. (për më tepër referojuni analizës së përgjithshme financiare në excel).

**29. Deklarime të personit të lidhur Gentiana Muçaj, e cila deklaron në Deklaratën *Vetting* llogaritë bankare dhe gjendjen e tyre në emër të fëmijëve:**

a) Llogari në Intesa Sanpaolo Bank (kursime) në emër të djalit E. M., vlera 3.331,15 (tre mijë e treqind e tridhjetë e një e pesëmbëdhjetë të qindtat) USD.

b) Llogari në Raiffeisen Bank në lekë (kursime) në emër të R. M., vlera 105.034,12 (njëqind e pesë mijë e tridhjetë e katër e dymbëdhjetë të qindtat) lekë.

**29.1.** Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit në Deklaratën *Vetting* me informacionin e përcjellë nga bankat duke mos u konstatuar problematika në lidhje me këto pasuri.

**30. Automjet tip “Audi A6”, në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë,** blerë në vitin 2005 nga znj. Gentiana Muçaj. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2005, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit Gentiana Muçaj ka deklaruar blerjen e një automjeti tip “Audi A6”, me targë \*\*\*, në emër të shtetasit A. Q., në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

**30.1.** Nga hetimi i kryer Komisionit i rezultoi se ky automjet nuk është konfirmuar nga DPSHTRR-ja në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe as i regjistruar ndonjëherë në emrin e saj. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se policia e parë TPL për këtë automjet është prerë në emër të shtetasit A. Q. pronar dhe shtetasit Arian Muçaj si përdorues në datën 31.7.2008.

**30.2.** Nga hetimi i kryer rezulton se znj. Gentiana Muçaj ka tërhequr nga llogaria (*overdraft*) pranë Raiffeisen Bank në datën 18.7.2005, shumën 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe në datën 28.7.2005 shumën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Në lidhje me kursimet në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë rezulton se të ardhurat nga paga janë të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume. Në analizë nuk janë përfshirë të ardhurat nga paga të bashkëshortit, si dhe nuk janë llogaritur shpenzime jetike përkatëse për këtë periudhë.

**30.3.** Rezulton se znj. Gentiana Muçaj ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 se ka përfituar 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë të ardhura nga shitja e këtij automjeti. Nuk u vlerësua të merret në konsideratë kjo shumë, pasi nuk provohet me dokumentacion blerja dhe shitja e këtij automjeti nga znj. Gentiana Muçaj. Ky automjet rezulton të jetë regjistruar në emrin e babait të znj. Gentiana Muçaj, i cili e ka blerë këtë mjet nga shtetasi A. Q.<sup>20</sup> në vitin 2009 dhe, më pas, e ka shitur atë në vitin 2010<sup>21</sup>, në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.

**30.4.** Komisioni kreu analizën financiare nga e cila nuk rezultuan problematika.

## **PASURI TË PERSONAVE TË LIDHUR**

**31.** Në bazë të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrim të deklaronte në Deklaratën *Vetting* sa i përket personave të lidhur dhe pasurive të tyre, si dhe burimit të krijimit apo detyrimeve financiare dhe interesave privatë. Duke qenë se ky detyrim

<sup>20</sup> Me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.4.2009, depozituar nga Gentiana Muçaj me pyetësorin nr. 2, datë 10.11.2022.

<sup>21</sup> Me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.2.2010, depozituar nga Gentiana Muçaj me pyetësorin nr. 2, datë 10.11.2022.

nuk është kryer nga subjekti rivlerësimit për shkaqet e referuara prej tij e shpjeguar më lartë në këtë vendim, Komisioni i ka kërkuar atij të deklarojë pasuritë e personave të lidhur, babait S. M., nënës E. M. dhe motrës R. M., të cilat pas deklarimeve në pyetësonin nr. 2, janë verifikuar nga Komisioni, i cili gjithashtu ka kryer hetime dhe verifikime në mënyrë të pavarur prej deklarimeve të bëra nga subjekti rivlerësimit.

**32. Apartament me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>**, në Fier, në lagjen “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, hyrja nr. \*\*\*, banesa nr. \*\*\*, kati \*\*\*, përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave nga shtetasit S. M., E. M., Arian Muçaj dhe R. M. sipas gjendjes së tyre familjare datë 1.12.1990. Subjekti ka bashkëlidhur në përgjigje të pyetësonit nr. 2 kontratën e shitjes datë 12.11.1998 të kësaj banese tek shtetasi R. D..

**32.1.** Në dosjen e ILDKPKI-së rezulton korrespondencë mes ish-ZVRPP Fier dhe ILDKPKI-së<sup>22</sup>, ku me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2017, ka përcjellë dosjen e pasurisë së mësipërme apartament i regjistruar me sipërfaqe 83.68 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën e mësipërme. Kjo shtëpi është privatizuar në vitin 1993 kundrejt vlerës 10.236 (dhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë dhe shitur në vitin 1998 tek shtetasi R. D. përkundrejt vlerës 1.950.000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

**32.2.** Për këtë pasuri nuk rezultuan problematika.

**33. Apartament me sipërfaqe ndërtimi 115.28 m<sup>2</sup>**, ndodhur në katin e pestë, blerë në vitin 2000 nga shtetasi S. M.. Adresa e banesës është pallati “\*\*\*\*” pas \*\*\*-it, blloku “\*\*\*\*”, Tiranë.

**33.1.** Subjekti ka paraqitur Kontratë Noteriale datë 21.10.2000 mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasit A. B. dhe S. M.. Vlera e shitjes është 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, e cila është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug<sup>23</sup> konfirmon se pasuria rezulton të jetë e regjistruar në sistemin përfundimtar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Prona vijon të përdoret nga babai sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit<sup>24</sup>.

**33.2.** Analiza financiare për këtë pasuri ka rezultuar pa problematika e se burim për këtë pasuri kanë shërbyer edhe të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Fier. Në këtë analizë financiare nuk janë konsideruar disa të ardhura të z. S. M. të deklaruara nga projektet dhe bashkëpunimet e Qendrës Studimore Albanologjike me institucione të huaja (Francë, Greqi etj.), për shkak të mosprovimit me dokumentacion të kohës, në të cilën janë përfituar këto të ardhura.

**33.3.** Në përfundim nuk kanë rezultuar problematika për këtë pasuri.

**34. Apartament me sipërfaqe totale 70.94 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Lezhë**, në pronësi të babait S. M., blerë me Kontratë Noteriale Shitjeje datë 2.8.2013, në vlerën 3.758.400 (tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë e katërqind) lekë. Burim i krijimit të kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat familjare të shtetasve S. M., E. M. dhe R. M..

**34.1.** Subjekti, në përgjigje të pyetësonit nr. 2 ka paraqitur disa dokumente<sup>25</sup>. Nga zyra e noterisë së noterit V. M.<sup>26</sup> konfirmohet transaksioni i lidhur përpara tij: Kontratë Shitjeje nr. \*\*\*, datë 2.8.2013, lidhur mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi D. L., përfaqësuar nga shtetasi G. D. me prokurë në cilësinë e shitësit dhe S. M. në cilësinë e blerësit. Në bazë të kësaj kontrate çmimi i shitblerjes prej 3.758.400 (tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekësh është likuiduar plotësisht nga blerësi, si dhe kanë mbetur për t’u paguar 200 (dyqind) euro për mirëmbajtjen e apartamentit për vitin e parë dhe

<sup>22</sup> Referojuni dosjes së ILDKPKI-së.

<sup>23</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2021.

<sup>24</sup> Referojuni pyetësonit nr. 2.

<sup>25</sup> Kontratë Porosie nr. \*\*\*, datë 30.7.2011 (notere Xh. B.) mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe S. M. – vlera e kontratës 24.000 euro; Lejë ndërtimi, miratuar me VKRRT Shëngjin nr. \*\*\*, datë 25.6.2010, lëshuar në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; vendim për miratimin e sheshit të ndërtimit nr. \*\*\*, datë 25.6.2010; Kontratë Shitjeje nr. \*\*\*, datë 2.8.2013, noter V. M. lidhur mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga D. L. përfaqësuar nga G. D. me prokurë në cilësinë e shitësit dhe S. M. në cilësinë e blerësit. Vërtetim nga dokumentet hipotekore të shitësit; Prokurë e Posaçme nr. \*\*\*, datë 11.8.2010, e cila i përmban tagrat e përfaqësimit të shoqërisë shitëse nga G. D.; Vërtetim hipotekor në emër të Skënder Muçajt për pasurinë apartament me sipërfaqe 62.64 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Shëngjin, Lezhë.

<sup>26</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2023.

lidhjen e kontratës së ujit dhe energjisë elektrike në vlerën 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro. Gjithashtu, tarifa e mirëmbajtjes prej 200 (dyqind) euro duhet të jetë e përvitshme në bazë të parashikimeve të Kontratës së Sipërmarrjes, por nuk rezultojnë gjurmë të kryerjes së këtyre pagesave<sup>27</sup>.

**34.2.** Referuar vlerave mesatare të miratuara për shitblerjen e banesave në tregun e lirë, për vitin 2011 në qytetin e Lezhës (Komuna Shëngjin), apartamenti i ndodhur në Shëngjin, z. k. \*\*\*<sup>28</sup>, rezulton me vlerë 25.503 (njëzet e pesë mijë e pesëqind e tre) euro<sup>29</sup> (70.94 m<sup>2</sup> x 359,5 euro/m<sup>2</sup>).

**34.3.** Gjatë hetimit rezultoi që të jenë depozituar dy mandatpagesa: (i) nr. \*\*\*, datë 30.7.2011; (ii) nr. \*\*\*, datë 15.3.2012<sup>30</sup> nga 10.000 (dhjetë mijë) euro të kryera nga shtetasi S. M. për shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. për likuidimin e apartamentit nr. \*\*\*, kati \*\*\*, i ndodhur në Shëngjin, Lezhë. Është depozituar një librezë energjie elektrike në emër të shtetasit S. M. për pasurinë me vendndodhje në Shëngjin, Lezhë, funksionale nga shtatori 2013, si dhe një librezë qiraje për ujë në emër të shtetasit S. M. për pasurinë e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., e ndodhur në Shëngjin, Lezhë, e cila është funksionale nga qershori 2013<sup>31</sup>.

**34.4.** Në analizën financiare janë marrë në konsideratë të ardhurat e babait, nënës dhe motrës së subjektit të rivlerësimit, nga e cila kanë rezultuar të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. S. M..

**34.5.** U verifikua mbi konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit të rivlerësimit<sup>32</sup> dhe bashkëshortes<sup>33</sup> së tij me shoqërinë shitëse “\*\*\*” sh.p.k., përfshirë administratorin/ortakun e shoqërisë D. L., nga ku nuk rezultuan të dhëna.

**34.6.** Në lidhje me këtë pasuri nuk u konstatuan problematika.

**35. Automjet tip “Mercedes-Benz”, në pronësi të shtetasës R. M.,** blerë në vitin 2015 në shumën 5.300 (pesë mijë e treqind) euro nëpërmjet Kontratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.9.2015, si dhe 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë shpenzime doganore dhe taksë regjistrimi. Burim i krijimit të kësaj pasurie janë deklaruar kursimet nga të ardhurat familjare të babait, nënës dhe motrës së subjektit të rivlerësimit. Aktualisht kjo pasuri rezulton t’i jetë shitur në vlerën 5.400 (pesë mijë e katërqind) euro shtetasit K. Z.. Subjekti ka paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dokumentacionin përkatës<sup>34</sup>.

**35.1.** Transaksioni i blerjes së automjetit në emër të motrës R. M. konfirmohet nga zyra e noteres Sh. Gj., si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor<sup>35</sup>. Automjeti i vitit të prodhimit 2006 rezulton të jetë blerë në vlerën 5.300 (pesë mijë e treqind) euro nga shitësi B. K.. Shitësi rezulton ta ketë importuar këtë automjet nga Gjermania me vlerë 3.990 (tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) euro, ku në deklaratën e zhdoganimit identifikohet edhe vlera e detyrimit të taksës doganore prej 119.767 (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekësh.

**35.2.** Në përgjigje të pyetësorit standard<sup>36</sup>, subjekti i rivlerësimit pohon se ka përdorur për udhëtime të gjata në Greqi automjetin e motrës R. M..

**35.3.** Nga hetimi i Komisionit rezultoi se automjeti është regjistruar me targë \*\*\*. Polica e parë TPL për këtë automjet është prerë në emër të shtetasve R. M. dhe Arian Muçaj, në datën

<sup>27</sup> Referuar Kontratës së Sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 30.7.2011, neni 9.

<sup>28</sup> Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*7 kol., datë 30.7.2011, vlera 24.000 euro.

<sup>29</sup> Referuar EKB-së, vlera në tregun e lirë të shitblerjes së apartamenteve në vitin 2011, për qytetin e Lezhës, Komuna Shëngjin është 49.720 lekë/m<sup>2</sup>.

<sup>30</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 7 të Gentiana Muçajt, protokolluar me nr. \*\*\*, datë 2.2.2023.

<sup>31</sup> Përgjigje të pyetësorit nr. 9 të Gentiana Muçajt, datë 15.2.2023, të dokumentuara elektronikisht nëpërmjet postës elektronike.

<sup>32</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.1.2024.

<sup>33</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2023. Administruar nga dosja e znj. Gentiana Muçaj.

<sup>34</sup> Kontratë Shitblerjeje Automjeti me akt noterial lidhur në datën 11.9.2015 mes shtetasve B. K. dhe R. M.; Kontratë Shitjeje Automjeti nr. \*\*\*, datë 4.10.2019, me shtetasen R. M., e përfaqësuar me prokurë nga shtetasi S. M. dhe K. Z..

<sup>35</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2023; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2023. Janë paraqitur: certifikatë e pronësisë së mjetit në emër të shtetasës R. M.; lejë qarkullimi; certifikatë kontrolli fizik të mjetit.

<sup>36</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, përgjigje e pyetjes nr. 8.

21.9.2015. Pothuajse për çdo vit policat janë prerë në emër të shtetasve Arian dhe R. M.. Për vitin 2017, TPL-ja është prerë vetëm në emër të z. Arian Muçaj.

**35.4.** Nga të dhënat e AMF-së rezulton se është prerë karton jeshil disa herë në periudhën 2016 – 2018 në emër të shtetasve Arian Muçaj dhe R. M. dhe automjeti rezulton të jetë përdorur nga z. Arian Muçaj. Pjesa më e madhe e lëvizjeve në drejtim të Greqisë është kryer së bashku me familjen, megjithatë nga sistemi TIMS vërehen lëvizje të z. Arian Muçaj me këtë automjet, të përdorur për qëllime personale, shoqërore ose pune.

**35.5.** Shtetasja R. M. nuk rezulton të ketë kryer lëvizje për jashtë vendit me këtë automjet. Ajo rezulton të ketë udhëtuar me automjete të tjera, përfshirë lëvizje me automjetin me targë \*\*\*, në pronësi të z. Arian Muçaj, ku ka qenë e shoqëruar prej tij.

**35.6.** Nga lëvizjet, të paktën jashtë shtetit, rezulton se ky automjet është përdorur më shumë nga z. Arian Muçaj dhe familja e tij sesa nga shtetasja R. M., ndërsa për qarkullimin e brendshëm në të gjitha policat e prera rezulton edhe emri i z. Arian Muçaj.

**35.7.** *Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në Deklaratën Vetting apo deklaratat periodike vjetore dhe nuk është deklaruar si pasuri e personit të lidhur, motrës së tij.*

**35.8.** Nga analiza financiare, motra e subjektit të rivlerësimit, rezulton në pamundësi financiare në shumën -177.080 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë) lekë për krijimin e kësaj pasurie.

Periudha	1.1.2015 – 11.9.2015
<b>Të ardhurat</b>	<b>1.328.675</b>
Të ardhurat nga paga S. M.	447.738
Të ardhurat nga paga E. M.	133.895
Të ardhurat nga paga R. M.	722.856
Të ardhurat nga interesat bankarë	24.186
<b>Shpenzime</b>	<b>598.552</b>
Shpenzime jetike	448.552
Shpenzime TIMS	0
Shpenzime doganore + taksë regjistrimi	150.000
<b>Pasuri</b>	<b>907.203</b>
Blerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, datë 11.9.2015, shuma 5.300 euro	729.545
Ndryshim likuiditeti	177.658
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-177.080</b>

**35.9.** Në përfundim të verifikimeve, duket se automjeti i regjistruar në pronësi të motrës është përdorur kryesisht nga subjekti i rivlerësimit, i cili nuk e ka deklaruar përdorimin e tij. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

**35.10.** Në vijim të prapësimeve, subjekti i rivlerësimit në lidhje me analizën financiare të mësipërme sqaron: *“Pas komunikimit me babanë dhe motrën ata kanë pasur kursime jashtë sistemit financiar në banesë në këtë periudhë, të cilat i kanë përdorur edhe për blerjen e automjetit. Gjithashtu, subjekti sugjeron që të merren në konsideratë shpenzime më të ulëta familjare dhe jo ato të përllogaritura sipas INSTAT-it, pasi ata janë në një moshë të konsiderueshme.*

*Në përgjigje të pyetësorit standard kam deklaruar me detaje se kam përdorur për udhëtime të gjata makinën e motrës R. M., duke e përmendur për çdo udhëtim të kryer. Nuk kam deklaruar përdorimin e këtij mjeti në Deklaratën Vetting, pasi nuk e kam konsideruar se plotësonte kriterin për të përshkruar këtë mjet në përdorimin tim. Nga ana ime është përdorur ky mjet për disa udhëtime gjatë kohës që motra jetonte në Itali, edhe për arsye se çdo automjet ka nevojë të përdoret, pasi nga mospërdorimi amortizohet dhe kërkon shpenzime të mëdha për riparim.*

*Në vazhdim të shpjegimeve, motra pas largimit në Itali i ka dhënë prokurë të posaçme për shitjen e këtij automjeti babait tim, i cili më 4 tetor 2019 e ka shitur këtë mjet nëpërmjet*

*Kontratës së Shitjes së Automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.10.2019, në shumën 5.400 (pesë mijë e katërqind) euro dhe lekët e përfituara nga shitja janë depozituar në numrin e llogarisë së motrës sime në Intesa Sanpaolo Bank”.*

**35.11. Në përfundim,** trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e subjektit në raport edhe me dokumentacionin e rezultuar dhe situatat faktike dhe arrin në konkluzionin se ajo është një marrëdhënie familjare, për të cilën pas rishikimit të të ardhurave dhe analizës financiare ata rezultojnë me burime financiare të mjaftueshme e të bollshme për krijimin e kësaj pasurie.

**36.** Trupi gjykues, pasi vlerësoi pasuritë e personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit, çmon se marrëdhënia e tij me bashkëshorten dhe fëmijët rezultoi ashtu sikurse u deklarua nga vetë subjekti i rivlerësimit, e ndarë edhe me ekonomi të veçantë në mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive. Nga hetimi nuk rezultoi ndonjë rrethanë e dyshimtë për hetime më të thelluara. Po ashtu, pasuritë e krijuara nga shtetasi S. M. dhe vajzat e tij rezultuan me burime financiare të ligjshme e më se të mjaftueshme për justifikimin e tyre. Gjithashtu, lidhur me këto pasuri, nuk u konstatuan problematika që të mund të ngrinin dyshime të arsyeshme për fshehje pasurie apo deklarime të rreme nga subjekti i rivlerësimit e, për më tepër, që vetë ushtrimi i detyrës prej tij fillon në datën 4.6.2015, duke hequr dyshimet për krijimin e këtyre situatave, për shkak të detyrës/funksionit të tij si prokuror.

### **Gjetje të tjera**

**37.** Nga verifikimet për personat e lidhur kanë rezultuar llogari bankare në emër të shtetases R. M. (motra e subjektit) dhe shtetasit S. M. (babai), si vijon:

**37.1.** Znj. R. M., depozitë me afat në UBA<sup>37</sup>, çelur në datën 13.6.2012 dhe balancë 37.998,54 (tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë e pesëdhjetë e katër të qindtat) euro, në datën 31.12.2016.

**37.2.** Rezulton se kjo depozitë është çelur në datën 13.6.2012, në shumë 36.138,13 (tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë e trembëdhjetë të qindtat) euro, e cila ka përfituar shtesa vetëm nga interesat deri në datën 31.12.2016. Kjo balancë rezulton në llogarinë në euro të shtetases R. M. dhe e investuar në depozitë me afat që në datën 7.9.2011 nëpërmjet këmbimit nga fondet gjendje në llogarinë në dollar dhe transferuar në llogarinë në euro.

**37.3.** Znj. R. M., depozitë me afat në UBA, çelur në datën 11.6.2014 dhe balancë 943.120,34 (nëntëqind e dyzet e tre mijë e njëqind e njëzet e tridhjetë e katër të qindtat) lekë, në datën 31.12.2016.

**37.3.1.** Rezulton se kjo depozitë është çelur në datën 11.6.2014, në shumën 910.000 (nëntëqind e dhjetë mijë) lekë, e cila është krijuar nga maturimi i depozitës në shumën 758.193,26 (shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre e njëzet e gjashtë të qindtat) lekë së bashku me balancën gjendje në llogarinë e pagës.

**37.4.** Znj. R. M., depozitë me afat në UBA, çelur në datën 21.10.2016, balancë 3.344.888 (tre milionë e treqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, në datën 31.12.2016.

**37.4.1.** Rezulton se kjo depozitë është çelur nga maturimi i depozitave të mëparshme dhe kaluar gjendje në llogari.

**37.5.** Znj. R. M., depozitë me afat në UBA, çelur në datën 18.7.2014 dhe balancë 8.285,77 (tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë e shtatëdhjetë e shtatë të qindtat) USD, në datën 31.12.2016.

**37.5.1.** Rezulton se kjo depozitë është çelur në datën 18.7.2014, në shumën 8.191,14 (tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një e katërmëdhjetë të qindtat) USD, e cila është krijuar nga maturimi i dy depozitave në shumat 4.973,09 (katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre e nëntë të qindtat) USD dhe 3.218,05 (tre mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë e pesë të qindtat) USD. Shtetasja

<sup>37</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2023.

R. M. ka çelur llogari në monedhën dollar në datën 13.12.2001, në të cilën i kreditohej paga dhe më pas fondet investoheshin në depozita. Gjithashtu, në këtë llogari në datën 5.5.2008 depoziton *cash* në llogari shumën 17.000 (shtatëmbëdhjetë mijë) USD, të cilat investohen në depozita dhe më pas konvertohen në monedhën euro, në datën 7.9.2011.

**37.6.** Znj. R. M., llogari në Intesa Sanpaolo Bank<sup>38</sup>, çelur në datën 6.9.2016, ku janë kryer depozitime *cash*, në total në shumën 2.165.000 (dy milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, duke filluar nga kjo datë, me burim të deklaruar në depozitime nga kursimet familjare.

**37.7.** Znj. R. M., llogari në Intesa Sanpaolo Bank<sup>39</sup>, çelur në datën 2.9.2016, ku janë kryer depozitime në total në shumën 7.200 (shtatë mijë e dyqind) euro, duke filluar nga kjo datë, me burim të deklaruar në depozitime nga kursimet familjare.

**37.8.** Nga analiza e burimeve rezulton se llogaritë apo depozitat e shtetases R. M. janë krijuar nga dy burime: (a) të ardhura nga paga, interesa nga depozitat, konvertime në valutë (euro, dollar); (b) derdhje *cash*, me burim deklaruar kursime të familjes, të cilat në total rezultojnë në shumën e konvertuar prej 12.286.764 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh [depozitim *cash* në shumën 17.000 (shtatëmbëdhjetë mijë) USD, në datën 5.5.2008; 9.086 (nëntë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) USD, në datën 8.10.2008; 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro, në datën 7.10.2008<sup>40</sup>; 2.165.000 (dy milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, në vitin 2016<sup>41</sup>; 7.200 (shtatë mijë e dyqind) euro, në vitin 2016<sup>42</sup>]. Nga analiza e burimeve të të ardhurave të prindërve dhe të saj rezulton se kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kursimeve dhe depozitimin e tyre, duke shtuar likuiditetet në bankë në vitin 2008. Gjithashtu, nga analiza financiare rezulton se edhe pas vitit 2013 (blerje e pasurisë apartament në Shëngjin), duket se familja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin e kursimeve familjare, të cilat kanë shërbyer si burim për shtimin e likuiditeteve në bankë.

**37.9.** Z. S. M., depozitë me afat në BKT<sup>43</sup>, e çelur në datën 7.2.2013 dhe balancë 1.000.000 (një milion) lekë, në datën 31.12.2016. Kjo depozitë është krijuar nga bashkimi i depozitës së çelur në datën 5.2.2010, në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, e cila transferohet nga llogaria e pagës së shtetasit S. M. në llogari depozite dhe nga transferimi i shumës 411.891,6 (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një e gjashtë të dhjetat) lekë, në datën 7.2.2013, nga llogaria e pagës. Të dyja këto shuma së bashku me interesat e përfituar nga depozita në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë bashkohen dhe çelet depozita në datën 7.2.2013, në shumën 1.000.000 (një milion) lekë.

**37.10.** Z. S. M., depozitë me afat në BKT, çelur në datën 12.2.2014 dhe balancë 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë, në datën 31.12.2016. Kjo depozitë është krijuar nga transferimi i shumës 926.000 (nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë nga llogaria e pagës në Raiffeisen Bank në llogarinë e pagës në BKT, në datën 11.2.2014, ku së bashku me balancën, gjendje në këtë llogari nga kreditimi i pagës, çel depozitën në datën 12.2.2014, në shumën 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë.

**37.11.** Nga verifikimi i llogarive bankare rezulton se këto likuiditete kryesisht janë krijuar nga veprimet e kryera me llogaritë bankare nga kreditimi i pagës dhe shpërblimeve nga paga (pra depozita të çelura me kursimet nga pagat, kalim nga një llogari bankare në tjetrën), duke investuar në depozita bankare, të cilat janë pasqyruar në analizën financiare nga momenti i krijimit të tyre dhe shtesat përkatëse gjatë viteve. Gjithashtu rezultojnë shtesa në depozitën në

<sup>38</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2024, dosja e hetimit.

<sup>39</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2024, dosja e hetimit.

<sup>40</sup> Kjo shumë është tërhequr nga llogaria e shtetasi S. M. në Alpha Bank, në datën 6.10.2008 dhe depozituar *cash* nga shtetasja R. M. në llogarinë në emër të saj pranë UBA Bank, në datën 7.10.2008. Këto fonde tërhiqen nga kjo llogari nga shtetasi S. M., si person i autorizuar, në datën 14.12.2009.

<sup>41</sup> Depozitim *cash* 440.000 lekë, në datën 6.9.2016; 525.000 lekë, në datën 13.9.2016; 500.000 (pesëqind mijë) lekë, në datën 16.9.2016; 700.000 lekë, në datën 17.10.2016.

<sup>42</sup> Depozitim *cash* 5.000 euro, në datën 2.9.2016 dhe 2.200 euro, në datën 6.9.2016.

<sup>43</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2024.

monedhën dollar në datën 5.5.2008, në shumën 17.000 (shtatëmbëdhjetë mijë) USD dhe në datën 8.10.2008, në shumën 9.086 (nëntë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) USD, krijuar nëpërmjet depozitimeve *cash*, për të cilat nuk është deklaruar burimi i krijimit të tyre.

**37.12.** Në përfundim të verifikimeve, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën *Vetting* këto pasuri të krijuara nga personat e lidhur me të, në bazë të nenit 3, pika 13 dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, dhe as burimin e krijimit të tyre, gjithashtu, as në pyetësonin nr. 2 të dërguar nga Komisioni, i pyetur mbi pasuritë e personave të lidhur. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të jap shpjegime lidhur me burimin e krijimit të pasurive (gjendjeve të likuiditeteve në bankë), për personat e lidhur sipas certifikatës së gjendjes familjare.

**37.13.** Në vijim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit sqaron: *“...Në lidhje me llogaritë bankare të motrës sime R. M., në kohën kur unë kam përgatitur përgjigjet ajo ka qenë në Itali dhe, siç kam shpjeguar më lart, e kisha të pamundur të siguroja të dhëna nga bankat shqiptare. Në lidhje me këto llogari, kam konstatuar se nga ana e Komisionit janë administruar balancat e llogarive të familjarëve të mi, për këtë arsye e konsiderova të plotësuar këtë kërkesë nga ana e Komisionit, pasi të gjitha të dhënat ishin administruar më parë”.*

**37.14.** Duke qenë se në vijim të prapësimeve subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me burimin e krijimit të depozitave bankare në emër të së motrës, konkretisht ato në vitin 2008 nëpërmjet depozitimeve *cash*, ai është pyetur edhe gjatë seancës dëgjimore për këtë çështje, ku ai nuk ka paraqitur shpjegime shtesë.

**38. Në përfundim,** trupi gjykues, pasi mori në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në raport me dokumentacionin e administruar, mundësinë e motrës dhe prindërve të tij për krijimin e tyre, si dhe periudhën në të cilën janë krijuar këto depozita, çmon se nga vlerësimi i situatave faktike krijohet bindja se marrdhënia e subjektit të rivlerësimit me familjen e tij të origjinës, ka qenë tërësisht e ndarë e se gjatë hetimit nuk janë vërejtur rrethana të tilla që të nxisin dyshime për hetime më të thelluara apo veprime si huadhënie, huamarrje, dhurime, etj që mund të ngrenë dyshime të qënësishme lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar ndaj vetë subjektit të rivlerësimit.

**39.** Trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe se ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme, për krijimin e tyre e mbulim e shpenzimeve.

Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e krijuar me burime të ligjshme dhe se nuk ka kryer deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

**40.** Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke iu përgjigjur pyetësorit të dërguar, si dhe pyetjeve shtesë në një kohë të shpejtë dhe duke dhënë në mënyrë të besueshme dhe shteruese informacionin e kërkuar.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**41.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Në përfundim është



dërguar në datën 2.11.2017 raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arian S. Muçaj. Me shkresën e datës 29.6.2022 është kryer përditësimi i informacionit.

**42.** Në vijim, AKSIK-ja ka dërguar në datën 21.11.2023 raportin për subjektin e rivlerësimit Arian Muçaj, të deklasifikuar plotësisht, duke konstatuar *përshtatshmërinë për vijimin e detyrës*.

**43.** Nga hetimet/verifikimet, Komisionit nuk i kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme për këtë subjekt.

**44. Në përfundim,** trupi gjykues, pasi shqyrtoi raportin e dërguar nga AKSIK-ja, informacionet nga organet ligjzbatuese, si dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

Nuk u provua që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 34-39 të kreut V të ligjit nr. 84/2016.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**45.** Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është hartuar mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, lidhur me 5 dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe 3 dosjeve të dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, si dhe të dhëna e *indicie* nga denoncimet lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit.

**46.** Nga vlerësimi i dosjeve, si dhe një denoncimi të paraqitur, nuk rezultuan të dhëna që mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin profesional. Gjithashtu, nuk u konstatuan të dhëna për hetime të mëtejshme ndaj *indicieve* të marra nga burime të hapura, si dhe nuk u vërejtën problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**47.** Lidhur me kriterin e aftësive profesionale (periudha e rivlerësimit qershor 2015 – dhjetor 2016), trupi gjykues çmon se për subjektin e rivlerësimit Arian Muçaj nuk janë konstatuar mangësi profesionale dhe, në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016 arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues të kërkuar, sipas neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, duke çmuar se subjekti:

- ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- ka arritur një nivel të kënaqshëm kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

dhe në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arian Muçaj, aktualisht me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 28.3.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**

**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**

**Relatore**

**Olsi KOMICI**

**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*

*Elda Faruku*